



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republik of Kosovo



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E VITISË - OPŠTINA VITINA



Komuna e Vitisë
Opština Vitina
Municipality of Viti/na

| | | | |
|---|-----------------|-------------------|--------------------|
| Pranuar - Primjeto Më/Dana <u>30.12.2016</u> vit/god. | | | |
| Nr. l organit Org. broj | Numri/Broj | Shtoiçë Prilog | Vlera Vrednosit |
| <u>01-</u> | <u>013/1961</u> | | |

Në bazë të nenit 12.2 pika d Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-40 (Gazeta zyrtare e Kuvendit të Republikës së Kosovës nr. 28/2008, dhe nenit 36 pika d) të Statutit të Komunës së Vitisë nr.01-013/491 të datës 21.04.2011, Kuvendi i Komunës së Vitisë në seancën e mbajtur më 29.12.2014 aprovon këtë:

V E N D I M
PËR CAKTIMIN E LARTËSISË SË KOMPENSIMIT MUJOR PËR
ANËTARIN E KOMISIONIT KOMUNAL TË AKSIONARËVE

Neni 1

Me këtë vendim, Kuvendi i Komunës së Vitisë APROVON Vendimin për caktimin e lartësisë së kompensimit mujorë për anëtarin e Komisionit Komunal të Aksionarëve në Kompaninë “Eco-Higjiena” (për pjesën publike të Kompanisë “Eco Higjiena”) në Gjilan.

Neni2.

Shuma e kompensimit të rregullt mujor për anëtarin e Komisionit Komunal të Aksionarëve në Kompaninë “Eco Higjiena” në Gjilan, caktohet në lartësi prej 100,00€ plus 50,00€ për çdo takim të mbajtur, por jo më shumë se dy takime brenda muajit.

Neni 3

Mjetet për kompensimin e anëtarit të Komisionit Komunal të Aksionarëve ndahen nga buxheti i Komunës – Kodi i pagave dhe mëditjeve të Drejtorisë për Financa, Ekonomi dhe Zhvillim.

Neni 4

Për zbatimin e këtij Vendimi, do të kujdeset Kryetari i Komunës, dhe Drejtoria për Financa, Ekonomi dhe Zhvillim e Komunës së Vitisë.

Neni 5

Ky Vendim, hyn në fuqi 15 ditë pas aprovimit nga Kuvendi i Komunës së Vitisë.

KRYESUESI I KUVENDIT
Naim Pira

